

PERISKOPI



Klubi për
Politikë të
Jashtme



Mosmarrëveshja e
tregtisë së lirë - CEFTA



Mosmarrëveshja e tregtisë së lirë - CEFTA

Para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kompanitë kosovare e kishin më lehtë dhe më lirë të zhvillonin bizneset e tyre dhe të promovonin produktet në tregun e rajonit. Si anëtare e CEFTA-s, Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Shteteve të Evropës Qendrore, Kosovës i ishte hapur një horizont i lirë tregtarë pa barriera doganore për të importuar dhe eksportuar qoftë lëndën e parë, qoftë produktet e gatshme.

Për prodhuesin e lëngjeve “Laberion”, me seli në Podujevë, kjo periudhë kujtohet me

lakmi pasi përfitimi i kompanisë nga tregu i hapur rajonal mundësoi punësimin e 70 punëtorëve dhe realizim vjetor mbi 2 milionë Euro.

Vitin pasues më 2009, “Laberion” pësoi rënie të shitjes për rreth 50% pasi Serbia bllokoi të gjitha mallrat dhe mjetet transportuese që hynin nga Kosova për shkak të vulës së Republikës së Kosovës në produktet e saj. Kjo masë ushtrohej edhe për mallrat që tentonin të plasoheshin gjetiu por transportoheshin përmes Serbisë.



Kryeredaktor:
Ylli Hoxha

Redaktore:
Besa Luci

Autor:
Driton Syla
Aridian Arifaj

Fotografite:
Gettyimages

Dizajni:
Trembelat

Kontakti
info@eklubi.eu
+ 381 38 221 881

Përkrahur nga FES




“Më 3 dhjetor 2008 na janë kthyer dy maune nga kufiri me Serbinë. Ne i kemi kthyer maunet dhe i kam informuar doganat dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)”, tregon Bashkim Osmani, drejtor gjeneral i kompanisë. “Ata [Doganat dhe MTI] më kanë premtuar se do ta zgjidhin problemin shumë shpejtë”.

Më shumë se një vit më vonë situata mbetet e bllokuar. Institucionet e Kosovës nuk ndërmarrin as një hap, ndërsa presin që problemi të zgjidhet nga bashkësia ndërkombëtare. Nga MTI-ja thonë se Komisioni Evropian dhe prania ndërkombëtare në Kosovë duhet të bëjnë presion në sekretariatit e CEFTA-s dhe mbi Serbinë për të pranuar Kosovën në këtë marrëveshje. Në anën tjetër, Komisioni Evropian zgjidhjen e sheh tek veprimi i akorduar me UNMIK-un apo edhe tek negociatat e drejtëpërdrejta me autoritetet përgjegjëse në Serbi. Serbia mban qëndrim konsistent duke refuzuar të pranojë çfarëdo që implikon statusin e shtetësisë së Kosovës.

Në konferencën e Klubit për Politikë të Jashtme mbi CEFTA-n, “Marrëveshjet Rajonale” të mbajtur në maj të vitit 2009, u rekomandua aplikimi i masave të reciprocitetit ndaj Serbisë. Kryesuesi i zyrës së Komisionit Evropian për Kosovë, Renzo Daviddi, kundërshtoi ashpër një qasje të tillë duke tërhequr vërejtjen për pasojat politike të këtij veprimi. Qëndrimi i tij bindi autoritetet kosovare duke izoluar idetë e alternativave ndaj raporteve asimetrike me Serbinë vetëm në qarqet e prodhuesve dhe shoqërisë civile. Nëntë muaj më vonë, Daviddi vazhdon të mban të njejtin qëndrim.

“Perspektiva ime nuk ka ndryshuar”, thotë ai. “Jam ende i bindur se vendimi për masa reciprociteti ndaj Serbisë nuk do të ishte veprim i mençur”.

Memli Krasniqi, Zëdhënës i Qeverisë së



Kosovës, e diskualifikon idenë për masa reciprociteti duke e konsideruar si joadekuate.

“Qeveria e Kosovës nuk do të shërbehet me shembuj të këqinj të të tjerëve në rajon. Çasja e Serbisë është jo konstruktive. Ne nuk kemi dashur me ndjekë modelin e saj karshi raporteve qoftë me Serbinë, qoftë me ndonjë prej fqinjëve tjerë”, thotë ai.

Ndërkohë, kompanive kosovare u mbetet të zbulojnë alternativa të kushtueshme për transportimin e mallrave të tyre ose të heqin dorë në tërësi nga ideja e eksportit që destinacione ka Serbinë. Ndërkohë deficitit tregtar i Kosovës është 1.7 miliardë Euro, ndërsa vetëm në raport me Serbinë arrin shifrën prej 200 milionë Euro.



Çka është CEFTA dhe a përfiton Kosova nga anëtarësimi në të?

Përfitimet e Kosovës nga CEFTA u cun-guan pasi Serbia bllo-koi të gjitha mallrat dhe mjetet transpor-tuese që hynin nga Kosova për shkak të vulës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja për Tregti të Lirë e Shteteve të Evropës Qendrore, e njohur sipas akronimit në gjuhën angleze CEFTA, u nënshkrua fillimisht në vitin 1992 në Varshavë, Poloni, me synimin që të krijohet një klimë e tregtisë së lirë në mes shteteve të ish-blokut të lindjes. CEFTA u mundësoi shteteve në tranzicion, si Çekia, Sllovakia, Hungaria, Polonia, Rumania, Sllove-nia dhe Bullgaria, të bënin tregti pa barierra doganore me njëra tjetrën, dhe që BE-ja të vëzhgonte dhe testonte se sa do të ishin në gjendje këto shtete ta pranojnë një koncept të ri të politikës tregtare. Shtetet e BE-së po ashtu investuan në mënyrë direkte në shtetet

e Evropës Qendrore duke shfrytëzuar kostot e ulëta të punës dhe lehtësim të taksave, dhe konsideronin investimet e sigurta mbase këto shtete një ditë do t'i bashkoheshin BE-së.

Me po të njëjtin paramendim, Bashkimi Evropian iu sugjeroi një marrëveshje të tillë shteteve të Evropës Juglindore. Në vitin 2006, në Bukuresht, Rumani, u lidh marrëveshja e CEFTA-s në mes të Kroacisë, Bosnje e Her-cegovinës, Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Kosovës, Shqipërisë dhe Moldavisë.

Nënshkrues i marrëveshjes për Kosovën ishte UNMIK-u dhe marrëveshja hyri në funksion për Kosovën në fund të vitit 2007.


Gjatë kësaj kohe, bizneset e Kosovës operonin brenda një tregu 22 milionësh.

Por jo shumë gjatë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008 - kur Pakoja e Ahtisarit duhej të miratohej nga Parlamenti i Kosovës në një afat prej 120 ditësh - UNMIK-u filloi bartjen e kompetencave tek institucionet e Republikës së Kosovës. Këto kompetenca përfshinin edhe doganat e shtetit.

Përfitimet e Kosovës nga CEFTA u cun-guan kur Kuvendi i Kosovës, më 11 nëntor 2008, miratoi Kodin doganor - të avancuar dhe të marrë nga Bashkimi Evropian - që futi në përdorim edhe vulën e Republikës së Kosovës. Që nga ai moment, çdo dokument valid, i vulosur nga çfarëdo institucioni kosovar dhe i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, nuk pranohej as nga dogana e as nga administrata tatimore serbe.

Të gjithë kamionët me prodhime kosovare që synonin Serbinë, qoftë për eksport apo vetëm tranzit, ktheheshin mbrapa sapo arrinin kufirin serb. Kurse mallrave nga Kosova që kishin për destinim eksporti Bosnjën e Hercegovinën nuk i'u pranoheshin certifikatat e origjinës, përsëri për shkak të vulës. Andaj, ato ngarkoheshin më tarifë të plotë doganore dhe si të tilla disfavorizoheshin, gjë që shkurajon kompanitë Kosovare për të eksportuar në Bosnjë. Kosova ka trashëguar CEFTA-n si të gjitha marrëveshjet e tjera që UNMIK-u i ka bërë në emër të saj gjatë periudhës 1999-2008. Mirëpo, sipas një analize të procesit të bartjes së marrëveshjeve nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës, Instituti për Studime të Avancuara GAP konkludon se Kosova është dashur të shqyrtojë dhe negociojë edhe një herë të gjitha ato marrëveshje; dhe që qeveria dhe MTI do të duhej t'i njoftonin shtetet nënshkruese të CEFTA-s se Kosova do t'i trashëgonte kompetencat e marrëveshjes.

“Për këtë çështje, Kosova kishte pasur



një bazë ligjore për të vepruar”, thotë Agron Demi, analist politikash në GAP. “Kjo jo vetëm që nuk është bërë brenda atyre 120 ditëve, por nuk është bërë as sot”.

Tani qeveria serbe vazhdon të arsyetojë se nënshkrues i vetëm legjitim i marrëveshjes është UNMIK-u. Në anën tjetër, si eksportuesi i dytë më i madh në Kosovë, pas Maqedonisë, Serbia vazhdon të përfitojë në përputhshmëri me marrëveshjen e CEFTA-as përderisa një mundësi të tillë ia ndalon Kosovës.

Sipas të dhënave për të hyrat nga Dogana e Kosovës, Serbia ka importuar në Kosovë rreth 200 milion Euro për vit, që përbën diku rreth një të tretën e importit të përgjithshëm të Kosovës. Ndërsa Kosova kishte eksportuar mallëra në vlerë prej shtatë milion Euro në Serbi dhe katër milion të tjera në Bosnje dhe Hercegovinë.

“Me siguri kjo shumë do të shkonte më shumë sikur të mos ishte ndërprerë eksporti në Serbi dhe tranziti nëpër të”, thotë Naim Huruglica, drejtori i përgjithshëm i doganës së Kosovës.



Minimizimi i rolit të CEFTA-s

Eksportet e Kosovës mezi arrijnë shifrën prej 100 milionë Euro në vit, dhe përbëhen kryesisht nga eksporti i mbeturinave të hekurit dhe metalit 49 për qind.


Përkundër këtij raporti asimetrik në marrëdhëniet mes dy vendeve dhe dëmeve evidente ekonomike, qëndrimet e akterëve ndërkombëtar janë që pasojat ekonomike të bllokadës serbe nuk janë edhe aq serioze dhe se ky dimension i raporteve në CEFTA nuk është aq dëmtesues për Kosovën.

Udhëheqësi i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian për Kosovë, Renzo Daviddi, tha se humbja e Kosovës nga CEFTA është minimale dhe që problemi me Serbinë mbetet

vetëm politik. “Mendoj që problemi sa i përket numrave nuk është aq domethënës”, tha Daviddi. “Mendoj që neto kontribumi i eksporteve në Serbi për Bruto Prodhimin Vendor (BPV) [në Kosovë] është diku rreth 0.05%. Dimensioni ekonomik është shumë i limituar, dhe thellësisht CEFTA është problem politik”.

Mirëpo trendet ekonomike nuk duket se përfillin konsideratat politike të Komisionit Evropian dhe zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës. Kosova gjatë dy viteve të fundit ka

■ Deficiti tregtar me vendet e CEFTA-s



pësuar rënie të ndjeshme të investimeve të huaja direkte derisa deficiti enorm tregtar në vitin 2009 u rrit edhe më tej.

Sipas Daviddit ngadalësimi i aktiviteteve ekonomike në masë të madhe ndërlidhet me ndikimet e krizës ekonomike globale. Kërkesa e shteteve Europiane për shumë produkte është zvogëluar dhe remitancat janë ulur, mbase të goditur nga kriza kanë pësuar ulje të nivelit të hyrave dhe përkatësisht të dërgesave.

Ndonëse edhe vendet e tjera të rajonit kanë pësuar rënie të eksporteve, ato në masë të madhe kanë ruajtur ose përmirësuar bilancin e përgjithshëm tregtar. Është vetëm Kosova ajo që edhe gjatë vitit 2009 ka thelluar ndjeshëm deficitin tregtar që aktualisht është më i larti në rajon. Sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian, deficiti tregtar paraqet 46% të BPV-së dhe është në rritje të vazhdueshme që nga viti 2007 kur shënonte lartësinë e 39% të BVP-së.

Masat e pamundura

Dhe deri më sot, Kosova nuk ka gjetur rrugë institucionale për të adresuar problemin e bllokadës. Ajo nuk ka mundur të parashtojë ankesë pranë Organizatës Botërore e Tregtisë (OBT) pasi që ende nuk është anëtare e saj, e madje as kërkesa për arbitrazh e paraqitur pranë sekretariatit të CEFTA-s nuk është aprovuar.

“Ministri Lutfi Zharku ka dërguar një shkresë [pas bllokimit më 2008] tek

të gjitha organet ndërkombëtare, dhe kryesia e CEFTA-s doli me një përgjigje se Komiteti i përhershëm nuk mund të mblidhet [mbi këtë çështje]”, thotë Sytrime Dërvisholli, zyrtare për CEFTA-n në MTI.

Shkresa të tilla u dërguan disa herë nga ministria dhe zëvendës-ministria në Sekretariatin e CEFTA-s, por pa sukses. Në njërin nga takimet e rregullta që i organizon sekretariati i CEFTA-s, të mbajtur në Mal të Zi në maj 2009, kishte marrë pjesë zëvendës-ministri i MTI-së dhe përfaqësuesit e tri nën-komiteteve nga të tre ministrinë kompetente. Që të katër përfaqësuesit lëshuan takimin për shkak të mbishkrimit UNMIK Kosovo, i cili sipas tyre nuk përfaqëson më Republikën

e Kosovës. Sipas zëdhënësit të qeverisë Krasniqi, qeveria e Kosovës beson se në kontakt me “përfaqësuesit e zyrës ndërlidhëse të KE-së në Kosovë dhe përfaqësuesit seniorë në Bruksel, kësaj çështje do t’i gjendet një zgjidhje sivist”. Në anën tjetër, sipas shefit të zyrës ndërlidhëse të KE-së, Daviddi, ka pasur një numër propozimesh për mënyrën se si përfaqësuesit e Kosovës do të mund të merrnin pjesë në takimet e CEFTA-s. “Ka pasur ide për aranzhime të ndryshme por të cilat do të kërkonin kompromis nga institucionet e Kosovës, të cilin me sa kuptoj unë, institucionet nuk janë gati të ndërmarrin”, thotë ai. “E kuptoj problemin politik, por nuk jemi duke ecur përpara”.

Alternativa ndaj CEFTA-s

Në konferencën e Klubit për Politikë të Jashtme “Marrëveshjet Rajonale”, mbajtur në maj 2009, alternativat e propozuara për qasje të Kosovës ndaj CEFTA-s përfshinin aplikimin e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosne dhe Hercegovinës, apo edhe daljen nga marrëveshja dhe lidhjen e marrëveshjeve bilaterale të tregëtisë së lirë me shtetet e interesuara.

Asokohe Daviddi kundërshtoi qasje të tilla, dhe vazhdon të mban të njëjtin qëndrim edhe sot.

“Do të mendoja dy herë para se të merrja hapa të tillë që nënkuptojnë shkëputje të marrëveshjeve, sepse një vendim i tillë do të barte çmim tepër të lartë ekonomik e besa çmim edhe më të lartë politik”, thotë Daviddi. “Në fund të fundit, mendoj se masat e reciprocitetit nuk dërgojnë askund edhe për shkak të pamundësisë së implementimit. Kapacitetit i Kosovës për të imponuar bllokimin e mallrave nga Serbia

është i limituar. Do të doja të shihja se si do ta zbatonit këtë bllokadë”.

Me këtë pajtohet edhe zyrtari i MTI-së duke e konsideruar kontrollin e kufirit si pengesë për implementim e masave të reciprocitetit. Por jo edhe zëdhënësi i qeverisë.

“Puna është se na nuk kemi dashtë me vendosë masa reciprociteti”, thotë Krasniqi. “Përndryshe, po të vinte deri tek ajo, unë besoj se do të ekzistonte kapaciteti i institucioneve me implementu një embargo të tillë”.

Drejtori i doganës së Kosovës Naim Huruglica thotë se po të krahasohen të dhënat e doganës serbe, ato që mblidhen nga EULEX-i në veri dhe ato nga terminali doganor në Mitrovicë, ato janë në masë prej 80% identike, ndërsa vetëm 20% e tyre hyjnë në të ashtuquajtura “të dhëna të dokumentacionit fiktiv”. Kjo nënkupton që kur një kompani prodhuese në Serbi ka destinim Kosovën, ai lirohet nga TVSH-ja e Serbisë me kusht që sasia e deklaruar për eksport do të shitet vetëm jashtë Serbisë. Me t’u zhdoganuar malli në Kosovë, kompania reimbursehet për TVSH-në e paguar paraprakisht në Serbi.

“Kështu që e gjithë kjo e hyrë mallrash që mund t’i takojë këtij 20%-shi ka të bëjë

më shumë me shpëlarje dokumentesh”, thotë Huruglica.

Ndërkohë, aktorët si Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Aleanca e Bizneseve, Instituti për Studime të Avancuara GAP, Instituti RIINVEST, Oda Ekonomike Amerikane kurrë më parë nuk janë ndjerë më të shpërfillur nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Analizat e Odës Ekonomike të Kosovës mbështesin masat e reciprocitetit që mbase do të kishin një efekt presioni tek vet prodhuesit dhe tregtarët serbë të cilët doemos do të bënin një presion tek qeveria e tyre për të hequr këto barriera - gjë që sipas tyre në mënyrë indirekte do ta ndikonte procesin pozitivisht. Safet Gërxhaliu, zëvendës-drejtor në OEK, thotë se “është absurde të mendosh se një Kosovë e dalë që 10 vite nga lufta mund të funksionojë pa një marrëveshje të tillë dhe qeveria nuk ka bërë asgjë që një vit”. Ai shton se për përfaqësuesit e bizneseve kosovare duhet të krijohet një frymë ekonomike sa më e volitshme e cila do të thithte investitorë. Pa një politikë ekonomike të mirëfilltë Kosova jo vetëm që nuk do të arrijë t’i bëjë prodhuesit e saj konkurrentë ndaj anëtarëve të CEFTA-s, por edhe do t’i shtyj kompanitë vendore drejtë falimentimit.

PYETJE DHE PËRGJIGJE ME SHEFIN E ZYRËS NDËRLIDHËSE TË KOMISIONIT EVROPIAN NË KOSOVË, RENZO DAVIDDI

Klubi për Politikë të Jashtme: Ka pasur një rënie të investimeve të huaja direkte dhe të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Si e vlerësoni situatën ekonomike në Kosovë?

Renzo Daviddi: Situata e përgjithshme ekonomike dhe investimet e huaja direkte janë të lidhura me zhvillimet e krizës ekonomike globale. Kosova, dhe përgjithësisht shumë vende të Ballkanit Perëndimor, janë ndikuar nga kriza ekonomike. Në fillim mund të ketë pasur një keqkuptim se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të ndikohen nga kriza. Por unë besoj se nëpërmjet disa kanaleve është transmetuar kjo sëmundje. Një prej këtyre kanaleve është ulja e përgjithshme e aktiviteteve ekonomike duke pasur më pak mundësi për eksport, e cila është zvogëluar në vendet e Evropës, ku shumë prej këtyre mallrave janë eksportuar. Kanali tjetër është se remitancat kanë pësuar rënie. Jo në masë të jashtëzakonshme, por ka pasur një rënie të qëndrueshme për shkak se njerëzit, në këtë rast kosovarët e punësuar jashtë, janë prekur nga kriza dhe me gjithë gjasë kjo ka zvogëluar kapacitetin e të ardhurave. Prandaj ata po dërgojnë më pak para në Kosovë. Këto janë disa nga efektet, por ka edhe të tjera të cilat janë të ndërlidhura me investimet e instrumenteve financiare.

Më pas është çështja se si këto kanë ndikuar investimet e huaja direkte. Këtu ka një ndikim negativ sepse ka më pak para në dispozicion dhe për shkak se disa prej



Renzo Daviddi,
udhëheqësi
i Zyrës
Ndërlidhëse
të Komisionit
Evropian në
Kosovë.

kompanive të cilat kanë investuar në disa prej projekteve të mëdha infrastrukturore, kanë më pak kapital në dispozicion. Për më tepër, Kosova është një treg i vogël dhe sinqerisht nuk besoj se edhe në rrethana normale do të kishte vërshim të investuesve të huaj të cilët do të vinin dhe investonin në Kosovë.

Aty ku unë shoh disa mundësi, posaçërisht për të ardhmen, janë dy apo tri projekte në zhvillim e sipër dhe të cilat mund të tërheqin disa investimet të huaja direkte.

Një prej këtyre projekteve është privatizimi i sistemit të telekomunikacionit (PTK); projekti tjetër është çështje e koncesionimit/privatizimit të aeroportit dhe çështja e investimeve në energji. Këto janë tri projektet e mëdha. Ndoshta jo aq të mëdha për shkak të shumës, por janë projekte të cilat mund të tërheqin investuesit mesatar, të cilët mund të jenë të interesuar për të investuar në rajon. Besoj se më 2011, për shkak se disa prej këtyre projekteve do të vazhdojnë përgjatë dy viteve të ardhshme, Kosova mund të ketë një mundësi për të tërhequr disa burime/investime.

KPJ: Edhe pse shifra është e parëndësishme, ka pasur një rënie të eksporteve që nga viti 2007. Në vitin 2009, ka pasur një rënie prej 39 përqind. Duke pasur parasysh që Kosova nuk eksporton shumë, si i vlerësoni ju këtë fakt? A është shqetësuese për Komisionin Evropian, ndonëse kemi një eksport të ulët, që kemi rënie të mëtejshme?

Renzo Daviddi: Sipas pikëpamjes sime, trendi nuk është shumë shqetësues. Si ekonomist, unë nuk do të isha i shqetësuar me rënien prej 39-40 përqind në eksport sepse ju po filloni nga një bazë shumë e ulët. Problemi është se Kosova nuk eksporton asgjë. Dhe ajo çfarë eksporton janë mbeturinat metalike dhe mallrat të cilat kanë shumë pak vlerë. Pra problemi, sipas këndvështrimit të politikave, është si të rritni eksportin për këtë vend dhe pastaj vetë trendi

mund të shpjegohet. Për shembull, një sasi e madhe e mbeturinave metalike janë eksportuar, të cilat më pas përdoren për prodhimin e çelikut dhe disa pjesë tjera. Është e qartë se prodhimi i çelikut në disa prej tregjeve evropiane ka pësuar një rënie gjatë viteve të fundit. Në këtë fushë ka pasur një rënie në kërkesë dhe kjo ndoshta është arsyeja pse kjo pjesë e eksportit nuk ka vazhduar apo është zvogëluar. Kjo mund të ringjallet. Problemi qëndron në atë se unë nuk jam shumë i sigurt që ju dëshironi të bazoni modelin tuaj ekonomik në eksportimin e mbeturinave metalike. Kjo është çështja më themelore sa i përket politikave.

KPJ: Në raportet e progresit të Komisionit Evropian, ne vazhdimisht lexojmë se Kosova duhet të punoj shumë në shkurtimin e deficitit të saj tregtar. Deficiti tregtar është shumë i madh pasi që Kosova kryesisht importon mallra dhe nuk eksporton. A tregojnë këto shifra diçka në lidhje me mënyrën e menaxhimit të këtij vendi?

Renzo Daviddi: Sipas mendimit tim, rënia është statistikisht e rëndësishme. Por sipas këndvështrimit të politikave, unë besoj se kjo nuk tregon shumë. Unë mendoj se ju duhet të pyesni veten se deri në çfarë mase ju mund të krijoni një ekonomi e cila funksionon ashtu siç e pohoni ju. Pra zvogëlo deficitin dhe në një periudhë të mëvonshme mund të krijohet situata kur eksportet mund të kenë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Ky është problemi i vërtetë sa i përket politikave dhe këtu mund të theksohen disa gjëra. Së pari, ju duhet të punoni në rritjen e eksportit [...] nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve të cilat janë konkurruese në tregun evropian dhe të cilat mund të eksportojnë mallra dhe shërbime të caktuara në tregun rajonal. Kjo nuk nënkupton domosdo ndërmarrje të mëdha. Kosova nuk ka llojin e strukturave ekonomike të cilat mund të mbështesin ndërmarrjet e mëdha: ky është modeli i së kaluarës. Një pjesë e rritjes së eksportit mund të vij nga ndërmarr-

rjet e vogla dhe të mesme me tregje të ngushta. Gjithsesi, edhe disa nga ndërmarrjet e mëdha mund të japin kontributin e tyre. Le të presim dhe shohim se si do të zhvillohen projektet e energjisë dhe energjisë elektrike. Ndoshta, në një fazë të mëvonshme, energjia do të mund të eksportohet. Por duke u bazuar në konsumin e tanishëm, unë nuk jam i sigurt që ju do të keni sasi të konsiderueshme të rrymës/mallrave të cilat do të mund të eksportoheshin. Pastaj kemi edhe çështjen e importit dhe janë disa gjëra të cilat mund të bëhen për zëvendësimin e mallrave të importuara. Kosova importon disa prodhime bujqësore të cilat unë mendoj se shumë lehtë mund të prodhohen nga prodhuesit vendas. Çështja mbi politikën qëndron në atë se si mund të ndërhyri me politikën e duhur bujqësore për të krijuar disa stimuj dhe për të siguruar se disa nga këto prodhime, si domatet, lakra dhe të tjera, prodhohen në vend. Unë besoj se nuk ju duhet një kornizë e sofistikuar ekonomike për t'i arritur këto gjëra.

KPJ: Ne kemi vështirësi për t'i eksportuar këto mallra në rajon. Në fakt çështja e CEFTA-s është arsyeja kryesore që ka nxitur KPJ për të zhvilluar këtë intervistë me ju. Tregu më i madh në rajon nuk është i hapur për prodhimet kosovare për shkak se Kosova bllokohet nga Serbia. Situata nuk është përmirësuar që nga hera e fundit kur kemi biseduar për CEFTA-n. Në maj të vitit të kaluar, mendimi juaj për të mos ndërmarr masa ka mbizotëruar. Megjithatë nuk ka pasur përparim sa i përket qasjes në tregun e Serbisë apo CEFTA-s. Cila është pikëpamja juaj sot?

Renzo Daviddi: Pikëpamja ime nuk ka ndryshuar. Por t'i kthehemi asaj që ju theksuat - tregut më të madh. I vetmi vend ku ka problem është Serbia dhe unë mendoj se këtu problemi sa i përket shifrave nuk është edhe aq i rëndësishëm. Unë besoj që eksporti neto i Serbisë në BPV [e Kosovës] duhet të jetë rreth 0,05 përq-

ind të BPV total. Unë e kuptoj aspektin politik por aspekti ekonomik është shumë i kufizuar. Kjo është vërejtja e parë. Vërejtja e dytë është se unë besoj që CEFTA është thellësisht një problem politik. Dhe të dyja palët, pala serbe dhe, deri në një masë, pala kosovare nuk kanë lëvizur shumë nga pozitat e tyre.

Mund të ketë shumë arsye për këtë, të cilat janë ngushtë të lidhura me rastin e Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Por çështja qëndron se nuk ka asnjë përpjekje për të lëvizur përpara një zgjidhje pragmatike, e cila mund të ndihmojë të zgjidh çështjen. Jemi në një situatë ku Serbia nuk ka ndryshuar pozitën e saj dhe ku Kosova nuk ka lëvizur nga qëndrimi i saj. Shembulli më i mirë është se Serbia do të kryesoj CEFTA-n për vitin 2010. Dhe natyrisht kemi probleme të mëdha sa i përket pjesëmarrjes së Kosovës në aktivitetet e CEFTA-s. Ndërsa në vitin 2011 Kosova do të kryesoj CEFTA-n. Të presim dhe të shohim; nëse nuk ndryshojmë gjërat thellësisht dhe mënyrën se si ato funksionojnë momentalisht, ne do të përballemi me problemet e njëjta vitin e ardhshëm.

KPJ: Kur deklaroni se institucionet e Kosovës nuk kanë lëvizur nga qëndrimi i tyre, çfarë nënkuptoni më saktësisht? Çfarë mund të bëjnë institucionet e Kosovës dhe a keni ju ndonjë propozim të veçantë se çfarë mund të bëjnë? Negociata me Serbinë brenda kornizës së CEFTA-s?

Renzo Daviddi: Janë disa propozime për mënyrën se si përfaqësuesit e Kosovës mund të marrin pjesë në takime të ndryshme dhe ekzistojnë aranzhime të ndryshme të cilat në fakt kërkojnë një lloj kompromisi nga ana e institucioneve të Kosovës, për të cilat institucionet nuk kanë gatishmërinë t'i ndërmarrin dhe unë këtë e kuptoj. Por unë e kuptoj problemin politik. Dhe ky është realiteti: ne nuk jemi duke lëvizur përpara.

KPJ: Por nuk jemi duke diskutuar vetëm për takimet. Dhe nuk ka të bëjë me përfaqësimin; ka të bëjë me bllokadë. Kosova nuk mund të eksportoj gjë në Serbi. Dhe po ashtu ka të bëjë me imazhin. Kur një investitor i huaj vendos të vij në rajon, Kosova ka këtë pamundësi dhe problem për të eksportuar në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë.

Renzo Daviddi: Kjo është një çështje tjetër; kjo është çështja e vulave. Kur Kosova ka shpallur pavarësinë, dokumentacioni i vulosur për mallrat të cilat janë dërguar në vendet tjera - në një model të veçantë sa i përket vendeve evropiane - është ndërruar sepse ishte shtypur UNMIK. Kjo vulë është ndërruar dhe i është komunikuar Komisionit Evropian - i cili është përgjegjës për informimin e të gjitha shteteve anëtarë të BE-s mbi vlefshmërinë e kësaj vule. KE ka informuar të gjitha 27 shtetet anëtare të BE-s, plus edhe vendet e rajonit. Për ne, Komisionin, kjo vulë është e vlefshme. Dëshmia është se diçka që është eksportuar nga Kosova në Itali apo Lituania nuk ka asnjë problem. Kjo për shkak se në modelin e BE-s [...] vula është e njohur si e tillë për arsye se Komisioni Evropian deklaroi se vula është e vlefshme dhe në rregull. Serbia është duke pohuar në baza bilaterale se kjo vulë është e papranueshme. Ky është një vendim bilateral i Serbisë dhe nuk ka të bëjë gjë me CEFTA-n. Të gjitha vendet tjera të CEFTA-s kanë njohur vulën si të vlefshme. Pastaj është çështja me Bosnje dhe Hercegovinën. Por Bosnja është duke ndjekur procedurën e duhur alternative. Ata theksojnë që "kjo vulë nuk është e njohur dhe ky mall, sipas mendimit tonë, nuk ka origjinë nga Kosova. Ne nuk mund të zbatojmë trajtimin preferencial. Ne thjesht do zbatojmë taksë doganore". Kjo dallon por nuk pengon mallin për lëvizje. Ata thjesht pohojnë se "ne nuk njohim mallin për shkak se është me origjinë nga një zonë doganore, që sipas mendimit tonë, nuk ka të drejtën për tregti preferenciale dhe prandaj do zbatojnë një

taksë doganore". Mirë. Ku qëndron problemi? Problemi qëndron se ka dy mënyra për të zgjidhur këtë problem - mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) ose CEFTA. Kosova nuk është anëtare e OBT-s dhe si pasojë nuk mund të zbatoj mekanizmin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kosova po has në probleme për të diskutuar këtë çështje brenda mekanizmit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të CEFTA-s. Ajo çfarë është bërë deri më tani është se kanë ekzistuar përpjekje nga disa aktorë, duke përfshirë edhe vetë Komisionin Evropian, për të bindur Serbinë se nuk kanë marr vendimin e drejtë për të ndaluar kalimin e mallrave.

KPJ: Nëse kjo çështje është bilaterale, ekzistojnë mekanizma apo masa që duhet ndërmarë në lidhje me këtë çështje. Shifrat tregojnë që Serbia eksporton mallra në vlerë prej 200 milion euro në Kosovë. Në konferencën e KPJ "Marrëveshjet Rajonale" në maj 2009, masat e reciprociteti janë përmendur si mundësi. Ju keni kundërshtuar idenë. Udhëheqësit politik deklarojnë se nuk mund të lëvizin në këtë çështje për shkak të trysnisë së Komisionit Evropian.

Renzo Daviddi: Unë jam ende i bindur se nuk është politikisht e pjekur për të bërë një gjë të tillë - për të vendosur masa të reciprocitetit. Kjo për shkak se ju do të bënit një deklaratë politike por në aspektin praktik të cilin e diskutuam, ndikimi ekonomik i kësaj deklarate do të ishte i vogël. Deklarata politike të cilën ju e bëni varet se sa mirë do të mund të menaxhoni këtë problem politik. Dhe kjo për shkak se mund të përdoret kundër ju ashtu siç është përdorur në favorin tuaj. Në përgjithësi, unë besoj se kjo nuk ju shpie askund për shkak se zbatimi praktik i kësaj mase dhe kapaciteti për të arritur këtë është i kufizuar. Unë me të vërtetë dua të shoh se si ju do të pengonit ... duke supozuar se dikush do të vendoste

ndalesë në mallrat të cilat vijnë nga Serbia. Dhe unë dua me të vërtetë të shoh se si dhe në cilën mënyrë mund të vendoset kjo ndalesë. Unë dua të shoh se si do të zbatohet në aspektin praktik. Prandaj ju do të ishit në një pozitë më të përkeqësuar për shkak se do të bëni një deklaratë politike e cila nuk do t'iu shpie askund. Kosova me gjithë gjasë do të ishte në pozitë më të keqe sepse do t'iu duhet të zëvendësoni mallrat, të cilat janë relativisht të lira, me mallra të importuara nga ndonjë vend tjetër dhe të cilat janë më të shtrenjta. Dhe po ashtu, unë besoj se kjo do të nënkuptonte edhe rreziqe të sigurisë gjatë zbatimit të këtyre masave, të cilat kanë një ndikim të kufizuar. Nëse dikush dëshiron të krijoj probleme politike, vetëm le të vazhdoj.

KPJ: Sa i përket kapaciteteve teknike për të vendosur ndalesën, a jeni duke sugjeruar që portat kufitare në veri janë problem?

Renzo Daviddi: Unë jam duke sugjeruar që kapaciteti për të kontrolluar kufirin është ende problem. Unë nuk jam i sigurt që ju keni masat për të kontrolluar plotësisht çdo mall që hyn dhe del nga Kosova.

KPJ: Pra ju jeni duke sugjeruar që institucionet e Kosovës nuk duhet të lëvizin apo ndërmarin ndonjë hap politik. Sugjerimi i vetëm është për të nisur bisedimet me Serbinë dhe pastaj për të gjetur një zgjidhje?

Renzo Daviddi: Unë sugjeroj që autoritetet e Kosovës duhet të vazhdojnë në pajtim me atë çfarë kanë ndjekur deri tani, e cila është të përmbahen nga vendosja e një ndalese për mallrat e importuara nga Serbia. Dhe autoritetet e Kosovës të vazhdojnë të mbështeten në kanalet nëpërmjet të cilat ushtrohet tryzni mbi Serbinë për të zgjidhur këtë çështje. Unë nuk e di se deri në çfarë mase autoritetet e Kosovës mund apo kanë gatishmërinë për t'u angazhuar në bisedime bilaterale, por sigurisht se ato mund

të arrijnë këtë nëpërmjet ndërmjetësimit të disa institucioneve.

KPJ: Megjithatë rezultati është bars me zero pas një viti. Pse duhet të përmbahen? Ku duhet të bazojnë arsyet e tyre? Për shkak se pozita e Serbisë nuk po ndryshon dhe Serbia po thekson se kurrë nuk do të lëviz nga ajo pozitë. Kjo pozitë është disi shumë e qëndrueshme.

Renzo Daviddi: Serbia ka deklaruar këtë gjë në lidhje me disa gjëra, por edhe në disa fusha tjera dhe ndërkohë gjërat kanë ndryshuar. Unë nuk po e kuptoj pse po i jepni kaq shumë rëndësi deklaratave të Serbisë në këtë aspekt. Që kur kam qenë këtu, kam parë një ndryshim të plotë të situatës në terren në lidhje me disa çështje të caktuara. Gjëja e parë që të bie ndërmend është pjesëmarrja e komunitetit Serb në zgjedhje në jug të vendit.

KPJ: Ne kemi një rast studimor në këtë raport që ka të bëjë me një prodhues nga Podujeva, i cili ka eksportuar disa nga prodhimet e tij në Serbi. Tani biznesi i tij është zvogëluar për 50 përqind. Cila është porosia juaj për të?

Renzo Daviddi: Unë do i thosha dy gjëra: së pari, ndoshta duhet të bëni përpjekje për të modifikuar tregun tuaj. Në fakt, një mall që është konkurrues në Serbi mund të jetë konkurrues si margjinë edhe në vendet tjera. Unë nuk jam i informuar se çfarë ka eksportuar ky prodhues në Serbi.

KPJ: Kompania ka eksportuar lëng portokalli.

Renzo Daviddi: Lëngu i portokallit është diçka që është relativisht... ekzistojnë kërkesa edhe për gjëra tjera. Pra kjo është diçka më se e sigurt për të deklaruar. Gjëja tjetër është se [prodhuesit] duhet të vazhdojnë trysinë mbi politikë-bërësit për të shqyrtuar dhe zgjidhur këtë çështje. Për shkak se kjo është një çështje që duhet të zgjidhet dhe lypset vëmendjen e vazhdueshme të politikë-bërësve.

Mali i Zi dhe Kosova DY SHTETE TË REJA POR MIKE TË VJETRA

**MARRËDHËNIET MES MALIT TË
ZI DHE KOSOVËS NUK KANË
QENË KURRË MË MIQËSORE
DHE MË TË AFËRTA. PODGORICA
DHE PRISHTINA SHPREHEN TË
KËNAQURA ME RAPORTET MES
TYRE**

Mali i Zi dhe Kosova janë dy shtetet më të reja në Evropë por kanë histori të përbashkët të vjetër dhe lidhje të afërta që kanë marrë formën e një miqësie të vërtetë. Sipas zyrtarëve të dy vendeve, të cilët kanë folur për Klubin për Politikë të Jashtme, marrëdhëniet mes dy vendeve vetëm sa po vijnë e përmirësohen edhe përkundër përpjekjeve të, siç shprehen, një kryeqyteti tjetër që të ndërhyjë mes Prishtinës e Podgoricës.

Edhe pse ka çështje të hapura mes dy vendeve, Prishtina dhe Podgorica këmbëngulin se të gjitha janë çështje teknike që presin të qartësohen dhe të pranohen nga të dyja palët. Për Prishtinën, dy çështjet më shqetësuese janë mundësia e tërheqjes së njohjes së Kosovës si shtet i pavarur në rast se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë gjykon se shpallja e pavarësisë është në

kundërshtim me Ligjin Ndërkombëtar si dhe çështja e demarkacionit të kufirit mes dy vendeve.

Zyrtarë të Podgoricës në anën tjetër ritheksojnë se vet kryeministri i vendit, z.Milo Gjukanoviq, ka thënë se nuk do të ketë kthim prapa në njohjen e Kosovës dhe shtojnë se këtë po refuzon ta kuptojë vetëm një kryeqytet në Ballkan. I pagënë cilësohet edhe problemi i demarkacionit të kufirit mes Kosovës e Malit të Zi dhe zyrtarët e Podgoricës shtojnë se kjo është një çështje teknike që shumë lehtë dhe shpejtë mund të mbyllet. Për më tepër, zyrtarët malazezë kërkojnë që Podgorica dhe Prishtina të mos lejojnë që mes tyre të futen palë të treta që do të tentonin të shfrytëzonin ndonjë çështje të mbetur hapur për të shkaktuar tensione mes Kosovës e Malit të Zi.

Podgorica ka përmendur dy çështje si prioritet të saj në marrëdhëniet me Kosovën: Njohja, apo thënë më mirë, ri-njohja e kombit malazez me kushtetutë si një prej grupeve etnike të Kosovës; si dhe kthimi i rreth 10.000 refugjatëve nga Kosova që ende jetojnë në Mal të Zi. Prishtina është shprehur e gatshme

që të bashkëpunojë me Podgoricën në këto dy çështje me rëndësi për fqinjin e saj.

**HISTORI E SHKURTËR E POLI-
TIKËS SË JASHTME TË MALIT TË
ZI DHE MARRËDHËNIEVE ME
KOSOVËN**

Mali i Zi u pavarësua në qershor të vitit 2006, pra jo shumë kohë para Kosovës. Që nga atëherë ka bërë hapa të shpejtë në ndërtimin e shtetit dhe ka shënuar suksese të ndjeshme në proceset e integritimeve evro-atlantike.

Ka zhvilluar me sukses zgjedhjet presidenciale në prill të vitit 2008 dhe ato parlamentare në mars 2009.

Mali i Zi është anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, në Këshillin e Evropës dhe në CEFTA (Marrëveshjen për tregti të lirë të Evropës Qendrore). Në vitin 2008 zyrtarisht ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe shpreson që këtë vit ta marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në



BE. Mali i Zi është edhe vend kandidat për anëtarësim në NATO pasi vitin a kaluar aleanca i ka ofruar Planin e Veprimit për Anëtarësim (Membership Action Plan).

Politika e jashtme e Malit të Zi ka zanafillën, së paku simbolikisht, në fillim të shekullit XVIII pasi në kuadër të përpjekjeve për pavarësi nga Perandoria Osmane, ky vend ka vënë marrëdhënie diplomatike me Rusinë dhe me Austrinë. Përfaqësinë e parë diplomatike Mali i Zi e ka hapur edhe para se t'i njihet pavarësia nga Perandoria Osmane dhe atë mu në Shkodër, që në atë kohë ende ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Një diplomaci e mirëfilltë fillon të zhvillohet pas pavarësimit të vendit nga Perandoria Osmane dhe fillimit të themelimit të përfaqësive në vende të ndryshme të botës.

Pas themelimit të Mbretërisë së Jugosllavisë dhe përfshirjes së Malit të Zi në këtë shtet, diplomacia dhe politika e jashtme e vendit shuhet për tu ringjallur përsëri në Jugosllavinë socialiste, ku Mali i Zi merr pjesë në mënyrë aktive në jetën diplomatike të vendit.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë So-

cialiste, diplomacia e Malit të Zi fillon të intensifikohet dhe ka luajtur një rol të madh në promovimin e aspiratave të këtij vendi për pavarësi.

Pas pavarësimit të vendit, Ministria e Jashtme e Malit të Zi ka marrë përgjegjësinë e plotë për politikën e jashtme të vendit. Vendi ka vënë një rrjet diplomatik në tërë globin duke hapur 22 ambasada, dy përfaqësi konsulore dhe gjashtë misione në organizata ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme të Malit të Zi ka caktuar si prioritet të politikës së saj të jashtme integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO, zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral.

MARRËDHËNIET E MALIT TË ZI ME KOSOVËN

Marrëdhëniet e Kosovës me Malin e Zi kanë fituar në kualitet sidomos në pranverën e vitit 1999, pas dëbimit të qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës nga



forcat serbe në drejtim të vendeve fqinje të Kosovës dhe pasi disa mijëra prej tyre kanë gjetur strehë dhe siguri në Mal të Zi.

Dy vendet janë afruar edhe më pas njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Mali i Zi, në tetor 2008. Edhe pse në media ka pasur njoftime se Mali i Zi do të mund të shqyrtonte vendimin për njohjen e Kosovës nëse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë vendos që shpallja e pavarësisë është ilegale, kjo nuk duket se do të ndodhë. Përkundrazi, më 15 janar 2010, Podgorica vendosi marrëdhënie diplomatike me Kosovën dhe tani pritet emërimi i përfaqësuesve diplomatikë nga të dy kryeqytetet.

Qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë në Mal të Zi pa viza ndërsa gjatë sezonit turistik veror vetëm me letërnjoftim.

Mali i Zi e ka përkrahur anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, duke votuar në favor të anëtarësimit të Kosovës.

Dy vendet kanë bashkëpunim edhe në sferën e ekonomisë. Në vitin 2008, shkëmbimi ekonomik mes dy vendeve ishte rreth 40 milion Euro.

Klubi për Politikë të Jashtme është organizatë joqeveritare e cila mbledh rreth vetës intelektual, politikan dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile, që tregojnë afinitet në politikë të jashtme. Klubi ka për qëllim që përmes një debati intelektual të kontribuojë përmes rekomandimeve në gjenerimin e politikave të jashtme të Kosovës, në funksion të paqes në Kosovë, rajon dhe botë. Klubi gjeneron debate, i analizon zhvillimet dhe jep rekomandime për politikën e jashtme të Kosovës; përqendrohet në analizimin e trendeve globale të cilat kanë ndikim në përditshmërinë politiko-ekonomike në Kosovë si dhe në hulumtimin e mundësive që i ofrohen Kosovës në një botë në integrim. Klubi do të përpiqet që të sjell në vëmendje debatet aktuale botërore në opinionin Kosovar dhe të tërheqë vëmendjen për hapat e domos-

doshëm të politikës kosovare karshi këtyre zhvillimeve.

Klubi përmes aktiviteteve të tij dhe një debati intensiv do të gjenerojë rekomandime dhe programe lidhur me proceset integruese rajonale, evropiane dhe globale, në veçanti në procesin e integritimit në BE dhe NATO, të cilat i vihen në dispozicion institucioneve të Kosovës. Fokus i veçantë i organizatës do të jetë zhvillimi i një debati mbi veprimet imediate që Institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin në rrafshin diplomatik në funksion të njohjes së Kosovës nga shtetet anëtare të OKB-së, si dhe pranimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç është OKB-ja, KE-ja, OSBE-ja, Banka Botërore, IMF, Organizata e Konferencës Islamike, Komiteti Olimpik etj. Klubi do të ketë për synim që të nxis një debat të tillë përderisa nuk arrihet njohja e Kosovës nga shumica e vendeve

botërore dhe pranimi i saj si anëtare e organizatave të lartpërmendura.

BORDI KLUBIT:

Veton Surroi (Kryetar), Venera Hajrullahu, Leonora Kryeziu, Valon Murati, Xhabir Hamiti and Ylli Hoxha (Drejtor Ekzekutiv).

KËSHILLI PROGRAMOR I KLUBIT:

Vlora Çitaku, Bujar Bukoshi, Ardian Gjini, Sadik Idriz, Ibrahim Gashi, Mimoza Kusari, Naser Rugova, Lulezim Peci, Luan Sllaku, Ilir Dugolli, Haki Abazi, Fatmir Aliu, Arjeta Emra, Antigona Baxhaku, Gëzim Salihu, Erolld Belegu, Fatmir Gashi dhe Agim Zogaj.

STAFI I KLUBIT:

Ylli Hoxha, Samir Reka, Venhar Nushi, Rrahim Sejdiu, Besa Luci, Driton Sylta, Ardian Arifaj, Hajrulla Çeku, Valentina Shyti, Kushtrim Dumoshi.



**Klubi për
Politikë të
Jashtme**